

SIMPOZIUM SHKENCOR NDËRKOMBËTAR

PAVARËSIA E KOSOVËS DHE SFIDAT E SHTETNDËRTIMIT



10-vjetori i Pavarësisë së Kosovës



Prishtinë, 17 maj 2018

Amfiteatri i Akademisë

Pjesëmarrësit:

1. Jusuf BAJRAKTARI (Prishtinë)
2. Beqir META (Tiranë)
3. Ksenofon KRISAFI (Tiranë)
4. Muhamedin KULLASHI (Prishtinë)
5. Arsim BAJRAMI (Prishtinë)
6. Sonja BISERKO (Beograd);
7. Islam LAUKA (Tiranë)
8. Anton PANCHEV (Sofje)
9. Teki KURTI (Tiranë)
10. Eva HYSKAJ (Tiranë)
11. Gjyljeta MUSHKOLAJ (Prishtinë)
12. Frashër DEMAJ (Prishtinë)
13. Esmeralda OSMANI (Tiranë)
14. Justina SHIROKA PULA (Prishtinë)

PROGRAMI I PUNËS

E enjte, 17 maj 2018

Simpoziumi fillon punimet në orën 10:00

SESIONI I PARË (10:00-12:50)

Kryesia e punës:

1. Jusuf BAJRAKTARI
2. Justina Shiroka PULA
3. Gjyljeta MUSHKOLAJ
4. Frashër DEMAJ

Fjala e hapjes: *Justina Shiroka-PULA*, Sekretare e Seksionit të Shkencave Shoqërore

1. *Jusuf BAJRAKTARI (Prishtinë)*
Dimensioni historik i Pavarësisë së Kosovës
2. *Beqir META (Tiranë)*
Konteksti ndërkombëtar i rezistencës paqësore të shqiptarëve të Kosovës i udhëhequr nga Presidenti Rugova në vitet e '90-ta
3. *Ksenofon KRISAFI (Tiranë)*
Rambuje, hap vendimtar drejt Pavarësisë së Kosovës

PUSHIM PËR KAFE (10.45-11:15)

4. *Muhamedin KULLASHI (Prishtinë)*
Evoluimi i opinionit ndërkombëtar rreth Pavarësisë së Kosovës
5. *Arsim BAJRAMI (Prishtinë)*
Konstitucionalizmi kosovar pas shpalljes së pavarësisë dhe sfidat e ndërtimit të tij
6. *Sonja BISERKO (Beograd)*
Sfidat regjionale për shtetndërtimin e Kosovës
7. *Islam LAUKA (Tiranë)*
Kërcënimi rus ndaj Kosovës

DISKUTIME (12:15-12:45)

DREKA (13:00-14:45)

SESIONI I DYTË 15:00-18:00

1. *Anton PANCHEV (Sofje)*

Sfidat e politikës së jashtme të Republikës së Kosovës dhe Presidenca bullgare e Këshillit të Bashkimit Evropian

2. *Teki KURTI (Tiranë)*

Kontributi i Shqipërisë me njohjen ndërkombëtare të Pavarësisë së Kosovës

PUSHIM PËR KAFE (15:30-16:00)

3. *Eva HYSKAJ (Tiranë)*

Pavarësimi i Kosovës, qasje ndaj identitetit të ri evropian

4. *Gjyljeta MUSHKOLAJ (Prishtinë)*

Partneriteti i Republikës së Kosovës me Strasburgun në lëmin e mbrojtjes së pakicave kombëtare

5. *Frashër DEMAJ (Prishtinë)*

Shpallja e Pavarësisë së Kosovës dhe njohja ndërkombëtare

6. *Esmeralda OSMANI (Tiranë)*

Liria dhe demokracia në realitetin e Kosovës në dekadën e pare dhe sfida për të ardhmen

7. *Justina SHIROKA PULA (Prishtinë)*

Sfidat dhe rritja ekonomike në Kosovë në periudhën 2008-2018

DISKUTIME PREJ 16:50-17:20

FJALA E MBYLLJES 17:30

Jusuf Bajraktari

ABSTRAKTE

ABSTRACTS

1. Jusuf BAJRAKTARI: DIMENSIONI HISTORIK I PAVARËSISË SË KOSOVËS

Këtë vit, kur me krenari po shënojmë disa jubile të rëndësishëm, nga e kaluara e jonë historike, pa dyshim, spikatë ngjarja më e re, e cila me të drejtë mban vulën më domethënëse të shumë përpjekjeve dhe sfidave të imponuara nga kërkesat e ligjshme që një popull e synon arritjen e objektivave kryesore identitare, siç është atributi *p a v a r ë s i a*.

Në këtë punim do të analizojmë me argumente, natyrisht, për aq sa lejojnë koha dhe kriteret shkencore, rrugën e gjatë të përpjekjeve dhe organizimeve politike e ushtarake për sendërtimin e kësaj ideje fisnike, që me këtë rast *po e shënojmë 10 vjetorin e Pavarësisë së Kosovës*. Kjo ngjarje madhore në historinë tonë veç vlerave kombëtare, ka edhe refleksione ndërkombëtare në sferën e gjeopolitikës evropiane. Kjo datë sikur i ka ndarë jo vetëm kujtimet për të kaluarën, por gjithnjë e më shumë simbolizon vlerësimet për ngritjen, përparimin dhe çlirimin e çdo avancimi apo ngecjeje të vlerave të jetës shoqërore, ekonomike e sociale të Kosovës. Në kumtesën time, do të analizojë gjithanshëm faktorët relevantë të cilët gjatë historisë e kanë kondicionuar dhe herë-herë fuçizuar idenë e Pavarësisë së Kosovës, e cila fatmirësisht u jetësua me dinjitet të plotë, pikërisht para dhjetë vjet e tre muaj.

Në këtë punim do të elaborohen e trajtohen në pika të shkurtra të gjitha ngjarjet e figurat kryesore nëpër etapa të veçanta historike nga Lidhja Shqiptare e Prizrenit, e cila edhe pak ditë shënon ditëlindjen e saj të 140, organizatë kjo e para e këtij lloji në aspektin politik dhe ushtarak në hapësirën tonë

kombëtare. Ajo kishte një program të avancuar politik për kohën, në bazë të të cilit u vunë themelet e kombit modern shqiptar dhe të afirmimit të ideve të Rilindjes Kombëtare Shqiptare e deri në aktin sublim të 17 shkurtit 2008, ditës së shpalljes së Kosovës shtet sovran e i pavarur. Ky akt sublim ka frymëzuar dhe vazhdon të inspiroj mendësinë kombëtare me të gjitha fushat kulturo-artistike, publicistike e shkencore.

Fjalët çelës: Kosova, Historia, Pavarësia, Rilindja Kombëtare Shqiptare, Lidhja Shqiptare e Prizrenit.

2. Beqir META: KONTEKSTI NDËRKOMBËTAR I REZISTENCËS PAQËSORE TË SHQIPTARËVE TË KOSOVËS E UDHËHEQUR NGA PRESIDENTI RUGOVA NË VITET 90

Kjo kumtesë do të trajtojë kontekstin ndërkombëtar të rezistencës paqësore të shqiptarëve të Kosovës në vitet 90-të.

Analiza që do të bëhet synon të krahasojë avantazhet dhe disavantazhet e gjendjes së shqiptarëve në vitet 90-të me situatën ndërkombëtare në Ballkan dhe në Evropë.

Për të analizuar situatën dhe natyrën e marrëdhënieve ndërkombëtare në Evropë dhe Ballkan i jam referuar literaturës përkatëse, kryesisht të huaj më relevante dhe njëkohësisht më të re.

- Analiza synon të zbulojë ata faktorë që ndikonin mbi çështjen shqiptar dhe mënyra se si ndikonin ato.

- Në përputhje me këtë analizë do të jepen gjykime edhe për formën e rezistencës që zgjodhën shqiptarët, dimensionet, shtrirjen, mesazhet ndërkombëtare e kombëtare që dha ajo, forcën e saj dhe impaktin kombëtar e ndërkombëtar të saj.

- Parahistoria dhe preludi i fillimit të kësaj rezistence do të analizohen për të krahasuar dimensionet e saj me thellësinë historike të rezistencës shqiptare.

- Roli i dr. Ibrahim Rugovës dhe i lidërshpimit të asaj kohe do të analizohen në kontekstin e këtyre shtjellimeve që përcaktuam më lart.

Fjalët çelës: Kosova, Rugova, Ballkani, Evropa, Diplomacia.

3. Ksenofon KRISAFI: RAMBUJE - PRELUDI I PAVARËSISË SË KOSOVËS

Marrëveshja e Rambujesë përbën një ndër hapat e rëndësishëm konstitutivë në rrugëtimin e gjatë historik të popullit shqiptar të Kosovës drejt lirisë dhe pavarësisë. Prandaj edhe punimi ynë fokusohet në evidentimin e rëndësisë së pamohueshme si dhe në analizën e disa prej aspekteve juridiko-ndërkombëtare të kësaj marrëveshjeje. Ajo vlerësohet si një nga momentet pararendës, si zanafilla e një procesi embrional njohjeje ndërkombëtare, i cili do të inkurajonte nisma e veprimtari juridiko-kushtetuese dhe juridiko-ndërkombëtare, që do të çonin drejt themelimit të shtetit të pavarur të Kosovës. Ky akt ndërkombëtar, produkt i një diplomacie intensive nga ana e faktorit relevant ndërkombëtar dhe bashkëpunimit të elitës politike kosovare, forcoi bindjen e ndërkombëtarëve se kishte ardhur koha e korigjimit të padrejtësisë së madhe historike të shek.. XX ndaj shqiptarëve. Duket se tashmë fuqitë e mëdha ishin ndërgjegjësuar për domosdoshmërinë e trajtimit të popullit shqiptar të Kosovës, sipas standardeve moderne. Ato u bindën për domosdoshmërinë e shpërputjes së lidhjeve të panatyrshme me Serbinë dhe ish-Jugosllavinë, për fillimin e procesit të pavarësisë së tij dhe integrimin në komunitetin e kombeve dhe shoqërive të lira politike.

Shqiptarët e Kosovës dëgjuan aleatët e mëdhenj, SHBA dhe BE, që këmbëngulnin për nënshkrimin e marrëveshjes së Rambujesë dhe patën kurajon të shpërfillnin edhe ndonjë “këshillë” paternaliste, me tone kërcënuese për të mos e nënshkruar, duke dëshmuar intuitë politike të admirueshme. Me firmën e tyre i bënë vendit të vet shërbimin më të madh, e

kthyen konferencën dhe marrëveshjen e Rambujesë në preludin e pavarësisë së Kosovës. Tërhoqën mbi vete bekime dhe vlerësime pozitive për largpamësinë, kurajon dhe maturinë e treguar. Vendimet e Rambujesë i hapën rrugën zyrtarizimit juridik të lirisë dhe më tej pavarësisë së Kosovës. Ngjarjet morën një drejtim fatlum, që mund të cilësohet pa hezitim, magjik. Qëndrimi obstruksionist, antishqiptar për të mos e firmosur marrëveshjen bëri që Serbia ta humbiste përfundimisht Kosovën, e cila shpëtoi njëherë e mirë nga zgjedha e saj.

Në optikën juridiko-ndërkombëtare Rambuje u bë pikënisja e lindjes së shtetit më të ri evropian, pasi për herë të parë u legjitimuan si palë me të drejta të barabarta përfaqësuesit e popullit të Kosovës. Çështja kosovare e mbetur pezull për rreth një shekull, mori dimensione të reja. Diplomacia perëndimore njohu dhe konfirmoi paritetin e palëve dialoguese. Kosovarët gëzuan të drejtën e tyre natyrore për të mbrojtur interesat politike, për të negociuar dhe për të vendosur fatin e vendit të vet.

Fjalët çelës: Marrëveshja e Rambujesë, Kosova, Shqiptarët, Diplomacia, SHBA, BE.

4. Muhamedin KULLASHI: EVOLUIMI I OPINIONIT NDËRKOMBËTAR RRETH PAVARËSISË SË KOSOVËS

5. Arsim BAJRAMI: KONSTITUCIONALIZMI KOSOVAR PAS SHPALLJES SË PAVARËSISË DHE SFIDAT E NDËRTIMIT TË TIJ

Republika e Kosovës, ka filluar një realitet të ri kushtetues, që kishte rezultuar pas miratimit të deklaratës së pavarësisë në Kuvendin e Kosovës me 17 shkurt 2008. Ky realitet i ri kushtetues ishte derivat i një mbikëqyrje ndërkombëtare të Kosovës për tetë (8) vite me radhë nga misioni i veçantë i Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB), që ishte një model krejt i veçantë i administrimit të një shteti nga ana e mekanizmave ndërkombëtar, në prizmin e praktikave krahasimore.

Pikërisht ky punim ka për qëllim të trajtojë disa aspekte të këtyre dimensioneve, që i japin përgjigje një pyetje themelore, dhe atë se çfarë konstitucionalizmi ka krijuar Kosova pas shpalljes së pavarësisë së saj. Natyrisht në kontekstin e konstitucionalizmit Kosovar, që është ndërtuar pothuajse dhjetë (dhjetë) vite pas shpalljes së pavarësisë, nuk mund të qëndrojmë indiferent nga zhvillimet kushtetuese dhe politike që i kanë paraprirë këtij konstitucionalizmi, këtu është fjala sidomos për ndikimin që ka pasur administrimi ndërkombëtar i Kosovës për krijimin e një niveli të konstitucionalizimit që ka Kosova sot.

Pas miratimit dhe hyrjes në fuqi të kushtetutës së Kosovës në vitin 2008, Kosova ka bërë hapin e parë drejt krijimit të një rendi kushtetues dhe konstitucionalizmi të saj. Funksonimi, zhvillimi dhe sfidat e konstitucionalizimit Kosovar pas miratimit dhe hyrjes në fuqi të kushtetutës, është varur nga

shumë faktor në shoqërinë Kosovare, sidomos faktorët politik. Andaj një dimension tjetër i rëndësishëm i punimit është edhe funksionimi, përparësitë por edhe sfidat që ka pasur zhvillimi i konstitucionalizmit Kosovar, në periudhën pas shpalljes së pavarësisë. Siç dihet nga teoria kushtetuese, konstitucionalizmi nuk është një proces i thjeshtë që varet vetëm nga të pasurit një kushtetutë, por më tepër varet nga zbatimi, interpretimi dhe sidomos raporti i kushtetutës me politikën.

Ky punim do të trajtohet në tri pjesë kryesore. Pjesa e parë ka të bëjë me atë se si ka ndikuar mbikëqyrja ndërkombëtare dhe administrimi ndërkombëtar i Kosovës, në nivelin e konstitucionalizmit Kosovar. Pjesa e dytë e punimit do të trajtojë risitë, përparësitë dhe vlerat e konstitucionalizmit Kosovar, kurse pjesa e fundit e punimit do t'i kushtohet sfidave të konstitucionalizmit në Kosovë, sidomos raportit me politikën.

Megjithatë pas këtyre viteve në të cilat do të kufizohet trajtimi i punimit, Kosova ka arritur që të krijojë disa shtylla të forta të konstitucionalizmit si dhe një identitet të qëndrueshëm kushtetues, i cili është duke e marrë vazhdimisht formën e tij.

Fjalët çelës: Konstitucionalizëm, Kushtetutë, rend kushtetues Kosovar, identitet kushtetues, gjykatë kushtetuese, sfida të konstitucionalizmit.

6. Sonja BISERKO: SFIDAT REGJIONALE PËR SHTETNDËRTIMIN E KOSOVËS

Međunarodni legitimitet Kosova će i dalje biti ključan za proces state buildinga na Kosovu. Nažalost, UNMIK je izgubio legitimnost u izgradnji državnosti, ali su isto tako podbacili i lokalni akteri. Otpor srpske zajednice da prihvati autoritet kosovskih institucija, posebno na severu, podriva napore u izgradnji stabilne multietničke države na Kosovu. Zbog unutrašnjeg (srpska zajednica) i vanjskog osporavanja kosovske države i pored duboke involviranosti međunarodne zajednice značajno je oštećen proces izgradnje kosovske države. Stav Srbije je ključan, jer od njega zavisi i ponašanje Rusije koja se sada postavlja kao zaštitinik srpskih interesa u međunarodnoj zajednici, pre svega u Savetu bezbednosti.

Fjalët çelës: Kosova, UNMIK, Rusija, Srbija.

7. Islam LAUKA: KËRCËNIMI RUS NDAJ KOSOVËS

Dhjetë vjet të ekzistencës së Kosovës si shtet i pavarur dëshmojnë se ajo është ballafaquar dhe vazhdon të ballafaqohet me një numër kërcënimesh të jashtme në fushën politike, ekonomike, informative dhe atë të sigurisë.

Ky është një fakt i pranuar nga shumica e analistëve, studiuesve, akademikëve dhe politikanëve. Problemi është se, ende, sot e kësaj dite, nuk është përcaktuar hierarkia e këtyre kërcënimeve. Për pasojë, ka paqartësi se cili është drejtimi themelor ku duhet të përqëndrohet puna e institucioneve të Kosovës për mbrojtjen e pavarësisë dhe forcimin e subjektivitetit ndërkombëtar të saj.

Roli i Rusisë është mjaft destruktiv karshi shtetit më të ri në botë – Kosovës. Sepse Moska tenton të mbaj peng situatën për arsye gjeopolitike e gjeostrategjike dhe për shkak të miqësisë jo të sinqertë ndaj Serbisë, kurse kjo e fundit duke instrumentalizuar serbët lokal dhe duke krijuar institucione paralele ilegale në Kosovën Veriore po shfrytëzon çdo mundësi për të mos lejuar Kosovën të funksionojë si shtet i pavarur.

Në këtë kumtesë bëhen përpjekje për të sjellur fakte dhe argumente në mbështetje të tezës që, midis kërcënimeve të jashtme të Kosovës, ai rus përbën kërcënimin kryesor.

Fjalët çelës: Hierarkia, Kosova, Politike, Ekonomia, Siguria, Rusia.

8. Anton PANCHEV: SFIDAT E POLITIKËS SË JASHTME TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE PRESIDENCA BULLGARE E KËSHILLIT TË BASHKIMIT EVROPIAN

Marrëdhëniet politike ndërmjet Bullgarisë dhe Kosovës janë në nivel të shumë të lartë dhe vazhdojnë të zhvillohen. Mbështetja bullgare ndaj Pavarësisë së Kosovës është paraqitur në forma të ndryshme, përfshirë edhe me deklaratën pozitive në favor të Kosovës në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë. Gjatë gjysmës së parë të vitit 2018 në politikën e jashtme të Republikës së Kosovës duhet të përfundojnë ose të vazhdojnë procese të rëndësishme, të cilat kanë ndikim direkt mbi zhvillimin dhe stabilitetin e Kosovës. Presidenca bullgare e Këshillit të BE-së përkon me këtë periudhë aktive për politikën e jashtme të Kosovës dhe mund të luajë një rol të rëndësishëm për ecjen e një pjese të këtyre proceseve.

Presidenca bullgare e Këshillit të Bashkimit Evropian është me rëndësi të veçantë për arritjen e përparimit të konsiderueshëm nga ana e Kosovës në shumë aspekte të politikës së jashtme, siç janë numri i njohjeve të pavarësisë së Republikës nga ana e shteteve-anëtare të BE-së, anëtarësia në organizata të rëndësishme ndërkombëtare, përfshirja e Kosovës në Strategjinë për zgjerimin e Bashkimit Evropian, liberalizimi i regjimit të vizave, negociatat me Serbinë me ndërmjetësiminë e BE-së etj. Këto janë temat kryesore, të cilat trajtohen dhe analizohen në këtë kumtesë.

Fjalët çelës: Kosova, Bullgaria, Presidenca, BE, Bashkëpunimi.

9. Teki KURTI: KONTRIBUTI I SHQIPËRISË ME NJOHJEN NDËRKOMBËTARE TË PAVARËSISË SË KOSOVËS

Me vendosjen e sistemit demokratik në Shqipëri pas viteve 90, çështja e Kosovës u bë çështje kryesore në politikën e saj në marrëdhëniet ndërkombëtare.

Shpallja dhe njohja ndërkombëtare e pavarësisë së Kosovës prej botës demokratike ishte pikë së pari kurorëzim i një rrugëtimit të gjatë përpjekjesh e sakrificash të pashembullta në historinë e njerëzimit nga vetë populli dhe inteligjenca e Kosovës.

Shqipëria në rrugën e konsolidimit ka arritur të fitojë një status dhe rol të ri në marrëdhëniet ndërkombëtare. Kështu, Shqipëria pas anëtarësimit në NATO, liberalizimit të vizave dhe aplikimit për statusin e vendit kandidat në BE, është kthyer në një vend strategjik për sigurinë, paqen dhe prosperitetin në rajonin e Ballkanit, Mesdheut dhe Europës.

Kjo i ka shërbyer inkurajimit të shqipëtarëve në Kosovë dhe rajon që të bëhen promotorë të integriteteve Europiane dhe Euroatlantike.

Shqipëria ka mbështetur dialogun e nivelit të lartë mes Kosovës dhe Serbisë, për të nisur një epokë të re me ndikim pozitiv në rajon.

Shërbimi diplomatic i Shqipërisë gjatë viteve 1990-2018 ka intensifikuar në vijimësi veprimtarinë në ndërmarrjen e hapave

që nxisin njohje të reja të Kosovës, anëtarësimit të saj në forumet rajonale e ndërkombëtare dhe integritit në BE.

Fjalët çelës: Pavarësia e Kosovës, Shqipëria, Integrimi Evropian, NATO.

10. Eva HYSKAJ: PAVARËSIMI I KOSOVËS, QASJE NDAJ IDENTITETIT TË RI EVROPIAN

Sot në botë flitet me të madhe dhe shkruhet për identitete të ndryshme. Dhe është pak a shumë e pranuar ekzistenca e shumë identiteteve edhe brenda një individi. Në varësi të rrethanave me të cilat ballafaqohet ai e përforcon njërin identitet më fuqishëm se tjetrin. Kjo normalisht vlen edhe për kombet e shtetet.

Për vendet anëtare të Bashkësisë Evropiane, kujtesa kolektive ka qenë udhërrëfyese qysh prej vitit 1945, çka lidhet me një interpretim konstruktiv të së shkuarës dhe një rikthim tek vlerat, siç është bashkëjetesa dhe bashkëpunimi paqësor. Nën një këndvështrim retrospektiv, kjo *Pax Europea* brenda Bashkësisë Evropiane mbështetet në katër elemente. Së pari, udhëheqësi e fortë dhe me ide emancipuese. Së dyti, elitat në vendet themeluese të Bashkësisë Evropiane të Qymyrit dhe Çelikut (*BEQÇ*) mbanin gjithmonë në vëmendje, si interesat (*e sigurisë dhe ekonomike*), ashtu edhe normat (*bashkëjetesa dhe dialogu*). Së treti, parametrat pozitivë të ekonomisë bënë që të rritej besimi i popullatës në projektin e integritimit dhe kësisoj u sigurua mbështetja qytetare, për qasjen e elitave me integritimin. Së fundi, një armik i përbashkët, BRSS-ja, farkëtoi një vullnet komunitar për t'i bërë ballë ndikimit të totalitarizmit.

“Diferenca midis mundësisë dhe realizimit” në politikën e jashtme evropiane, bashkëpunimi Bashkësi Evropiane–NATO, gjatë krizës së Kosovës, tregoi se Evropa po i nënshtrohet një procesi të shoqërizimit. Në këtë trajtëse do të përpiqemi të analizojmë faktet se pse shteti i ri i Kosovës është pjese integrale e familjes evropiane ashtu si dhe kombet themeltare te saj.

Fjalët çelës: Identiteti, Bashkimi Evropian, Civilizimi, Kosova

11. Gjyljeta MUSHKOLAJ: PARTNERITETI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS ME STRASBURGUN NË LËMIN E MBROJTJES SË PAKICAVE KOMBETARE

Ky punim ka për qëllim që ti trajtojë raportet e veçanta dhe tejet të ndërlikuara të Republikës së Kosovës me Këshillin e Evropës, disajnin kushtetues të saj bazuar në instrumentet e Këshillit të Evropës për mbrojtjen e pakicave kombëtare dhe rolin e jurisprudencës kushtetuese të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës në mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve jo-shumicë në Kosovë.

Shqyrtimi i zbatimit të instrumenteve të Këshillit të Evropës për mbrojtjen e pakicave kombëtare ka rëndësi jo vetëm për studimin e raporteve të Kosovës me këtë organizatë gjithë-evropiane, por edhe për studimin e rrugëtimit për në Bashkimin Evropian. Edhe pse organizata të ndara, kur bëhet fjalë për çështjet më të ndjeshme dhe më të vështira të përmbushjes së kushteve politike, siç është statusi dhe trajtimi i pakicave kombëtare, BE-ja i referohet standardeve të përcaktuara nga Këshilli i Evropës, që me të drejtë edhe quhen “acquis para-pranimit.”

Punimi do të përqëndrohet edhe në analizimin e rrethanave të nxjerrjes së Kushtetutës së Republikës së Kosovës, sepse ajo nuk mund të vlerësohet në vakum. Fakti se Kushtetuta e Kosovës është produkt i një procesi të gjatë negociator nën kujdesin e Kombeve të Bashkuara që rezultoi në Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës të dorëzuar nga i Dërguari i Posaçëm i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, e shpjegon përfshirjen e garancive më të avancuara për

mbrojtjen e të të drejtave të pakicave kombëtare në përputhje me standardet më të larta ndërkombëtare dhe evropiane, si dhe mekanizmat kompleks të përpjesëtimit të pushtetit, si rezultat i institucionalizimit të 'multietnicitetit', pavarësisht se Kosova numerikisht nuk i ngjanë një shoqërie multietnike.

Për të kuptuar raportet e Republikës së Kosovës me Këshillin e Evropës, si i vetmi vend demokratik në hapësirën gjeografike të Evropës i pa anëtarësuar ende në këtë organizatë të rëndësishme, do t'i analizojmë edhe hapat që Kosova i ka ndërmarrë, si dhe ata që nuk i ka ndërmarrë drejtë anëtarësimit.

I gjithë punimi do të mbështetet edhe në shqyrtim krahasimtar, sepse kjo do të ndihmojë, jo vetëm për të kuptuar sistemet e tjera, por për të kuptuar më mirë edhe sistemin tonë.

Fjalët çelës: Republika e Kosovës, Strasburgu, Këshilli i Evropës, Statusi i Kosovës.

12. Frashër DEMAJ: PAVARËSIA E KOSOVËS DHE NJOHJA NDERKOMBËTARE

Shpallja e pavarësisë së Kosovës ishte hap politik i koordinuar me faktorët e rëndësishëm të diplomacisë ndërkombëtare, të SHBA dhe vendeve kryesore të Bashkimit Evropian. Pas 17 shkurtit të vitit 2008 sfidë kryesore mbeti njohja ndërkombëtare e pavarësisë së Kosovës. Diplomati e studiues nga fusha të ndryshme, njohjet i ndanë në “njohje cilësore” dhe “njohje sasimore”. Në njohjet cilësore u futën shtetet e zhvilluara dhe me potencial të madh politik, ekonomik, diplomatik, ushtarak e strategjik si SHBA, Gjermania, Franca, Britania e Madhe, Italia etj. Kurse në “njohjet sasimore” futën shtetet të cilat pavarësisht potencialeve janë të rëndësishme duke pasur parasysh se numri i njohjeve ndërkombëtare të shtetësisë së Kosovës i hap rrugë për anëtarësim dhe bashkëpunim ndërkombëtar. Sfidë në vete përbën mosnjohja nga pesë vendet anëtare të BE-së. Ky fakt ndikon direkt në stabilitetin e vendit dhe në perspektiven e qytetarëve të Kosovës.

Një pjesë të madhe të përgjegjësisë e mbajnë edhe institucionet e Republikës së Kosovës, sidomos ministria e Punëve të Jashtme, ambasadat, konsulatat dhe shërbimi diplomatik në përgjithësi. Qeveria e Kosovës në shumicën e rasteve ka akredituar në diplomaci kuadra politik e shumë më pak profesionistë dhe diplomatë të karrierës. Ky fakt ka ndikuar drejtpërdrejt edhe në stagnimin e njohjeve ndërkombëtare të shtetësisë së Kosovës, mungesën e bashkëpunimit

ndërkombëtar e në veçanti dështimin e diplomacisë ekonomike dhe mungesën e investimeve të huaja.

Kosova duhet të thellojë edhe më shumë bashkëpunimin me SHBA-në, BE dhe faktorë tjerë relevant në interes të rritjes së efikasitetit dhe shtimin e numrit të njohjeve ndërkombëtare për Kosovën.

Fjalët çelës: Pavarësia, Kosova, Bashkimi Evropian, SHBA.

13. Esmeralda OSMANI: LIRIA DHE DEMOKRACIA NË REALITETIN E KOSOVËS NË DEKADËN E PARË TË PAVARËSISË DHE SI SFIDA PËR TË ARDHMEN

Në fokus të këtij punimi është trajtimi i karakterit demokratik të shtetit të Kosovës dhe sfidat e tij për realizimin e standardeve moderne të qeverisjes, për t'iu bashkuar familjes politike evropiane. Gjithashtu, merret në analizë progresi i padiskutueshëm në zhvillimin dhe promovimin e demokracisë si dhe në ndërtimin e shtetit të së drejtës. Me gjithë entuziazmin e përligjur të orës kulminante të historisë së vet, shteti i Kosovës, edhe pse rendit me krenari një sërë arritjesh substanciale, disa dimensione të jetës shtetërore të tij kërkojnë doemos angazhim tërësor për të konsoliduar respektimin e parimeve universale demokratike dhe sundimin e shtetit të së drejtës. Suksesi i vitalitetit të një shteti bazohet *inter alia* tek forca e demokracisë dhe lirisë dhe si detyrë e misioni i shenjtë i shteteve post-modernë del gjetja dhe implementimi i modaliteteve, mekanizmave e procedurave që strukturat shtetërore duhet të përfshijnë në politikat e tyre për krijimin dhe garantimin e hapësirave të lirisë për shtetasit, si dhe të parametrave moralë dhe racionalë të njeriut të lirë, mungesa e të cilave përbën pengesë për progresin e integritimit evropian.

Nuk mund të mos evidentohen përpjekjet serioze të klasës politike të Kosovës për stabilitet politik, qeverisje të qëndrueshme dhe konsolidim institucional. Megjithatë, dekadën e parë të shtetit të tyre të pavarur kosovarët e festuan në një mjedis politiko-social të karakterizuar edhe nga disa shfaqje të mungesës së hapësirave të lirisë së dëshiruar. Shtetet

nuk janë qënie perfekte, andaj mangësitë që dallohen herëherës në mikrokozmosin e demokracisë së Kosovës, kanë bërë që demokracia më e re evropiane të vlerësohet si një demokraci e brishtë, hibride, *sui generis*. Duhet theksuar se politikbërja nuk është një makinë deterministe e përsosur. Ajo konsiderohet si një proces evolutiv organizimi dhe administrimi, që zhvillohet dhe përparon duke mbledhur përvojat e veta. Si e tillë shndërrohet në një organizëm vital, ku shtetasit me aftësinë e tyre kritike korrektojnë çdo shfaqje spontane privuese kundrejt progresit të pandalshëm kah standardeve moderne të lirisë e demokracisë autentike. Ky jubile i pavarësisë ka si lejtmotiv për të gjithë shoqërinë politike të Kosovës se liria duhet të hedhe shtat e të forcohet dhe se qytetarët e vendit të shqiptonjave nuk janë spektatorë, por aktorë aktivë në formësimin e një shoqërie të mirëorganizuar në themel të së cilës qëndron koncepti universal i lirisë, drejtësisë, dhe demokracisë.

Fjalët çelës: Kosova, Liria, Demokracia, Drejtësia, Shtetësia, Politika, Psikologjia Evropiane.

14. Justina Shiroka PULA: SFIDAT DHE RITJA EKONOMIKE NË KOSOVË NË PERIUdhËN 2008-2018

Ky studim do të shprehë ecuritë ekonomike të kësaj periudhe kohore, duke i analizuar potencialet ekonomike, trendët e zhvillimit të ndërmarrjeve, sfidat, perspektivën dhe ndikimin e tyre në zhvillimin ekonomik. Objektivi kryesor i studimit është testimi i trendit të rritjes ekonomike në periudhën 2008-2018 në rastin e Kosovës, duke përdorur disa nga indikatorët ekonomikë, si: Shpenzimet Publike, Produkti i Brendshëm Bruto (PBB), Bilanci tregtar (eksport/import), të Ardhurat Totale Buxhetore. etj. Metodologjia e përdorur në këtë punim përfshin analizat, të dhënat statistikore dhe krahasimin e rezultateve të arritura. Vlerësimet janë bërë për të dhënat e serive kohore që përfshijnë vitet prej 2008 deri në vitin 2018. Të dhënat për indikatorët ekonomikë vendorë janë marrë nga databaza e Bankës Qendrore, nga Ministria e Financave, Enti i Statistikave i Kosovës, Banka Botërore dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar. Ky studim ofron dëshmi që disa indikatorë ekonomikë kanë ndikim të theksuar në rritjen ekonomike dhe janë faktorë shumë të rëndësishëm të zhvillimit ekonomik të Kosovës. Pavarësisht këtyre indikatorëve ekonomikë, krijimi dhe zhvillimi i bizneseve të vogla duhet të konsiderohet faktor shtytës i dinamikës zhvillimore, duke rezultuar se ato vazhdojnë të jenë bartëse kryesore të gjenerimit të vendeve të reja të punës. Kosova është një ekonomi tranzitore, prandaj rekomandojmë që qeveria të fokusohet në shpenzimet publike, si një faktor ekzogjen për të përmirësuar në vazhdimësi mjedisin biznesor, në nxitjen e reformës

ekonomike, në avancimin e infrastrukturën ligjore, e cila do të mundësojë përkrahjen e sektorit privat. Një nga sfidat me të cilat shteti i Kosovës po përballet në periudha të ndryshme të zhvillimit është harmonizimi i legjislacionit vendor me legjislacionin e Bashkimit Evropian. Për këtë arsye janë definuar mirë të gjithë mekanizmat për sigurimin e përshtatshmërisë së Legjislacionit të Kosovës me Acquis-Communitaire të Bashkimit Evropian. Sfidë tjetër është edhe bashkëpunimi i Kosovës me institucionet ndërkombëtare. Menjëherë pas shpalljes së pavarësisë, më 17.02.2018, Kosova u anëtarësua në shumë institucione ndërkombëtare, si në Bankën Botërore (BB), në Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN) dhe në Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH). Anëtarësimi në këto institucione ka mundësuar që Kosova të krijojë siguri ekonomike dhe ta rrisë imazhin e saj në tregjet financiare. Rrjedhimisht, ndikimi i parametrave makroekonomikë dhe shfrytëzimi i kujdesshëm i instrumenteve ekonomike, jo vetëm që do ta stimulojë rritjen ekonomike, por do të bëjë që ky të mbetet një prej prioriteteve me rëndësi të veçantë për politikëbërësit në Kosovë.

Fjalët çelës: Rritja ekonomike, Bilanci tregtar, Mjedisi biznesor, Institucionet Ndërkombëtare

KËSHILLI ORGANIZUES:

Akademik Jusuf BAJRAKTARI, kryetar

Akademik Ali ALIU, anëtar

Anëtar korrespondent Frashër DEMAJ, Sekretar

Anëtare korrespondente Gjyljeta MUSHKOLAJ, anëtare

Anëtar korrespondent Muhamedin KULLASHI, anëtar

*Secili referues duhet t'i përmbahet kohës deri në 10 minuta për të paraqitur kumtesën.

*Secili diskutues duhet t'i përmbahet kohës deri në 3 minuta ose diskutimin për problemin e caktuar t'ia dorëzojë Sekretarisë me shkrim.